



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR

VENDIM

PËR

LLOJIN DHE KARAKTERISTIKAT TEKNIKE QË DUHET TË PLOTËSOJNË SISTEMET DHE PAJISJET E IDENTIFIKIMIT ELEKTRONIK TË ZGJEDHËSVE, QË PROKUROHEN DHE PËRDOREN NË ZGJEDHJE, NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

(ndryshuar me Vendimin nr. 5, datë 10.2.2023)

Komisioni Rregullator, në mbledhjen e tij të datës 31.10.2020, me pjesëmarrjen e:

Iirjana NANO-	Kryetare
Arens ÇELA -	Anëtar
Dritan ÇAKA -	Anëtar
Helga VUKAJ -	Anëtar
Muharrem ÇAKAJ -	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKTI: Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e identifikimit elektronik të zgjedhësve, që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje, në Republikën e Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 20, pika 1, germa “e”, neni 22, pika 1 dhe 3, e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Rregullator, në zbatim të nenit 20, pika 1, germa "e", nenit 22, pika 1 dhe 3 e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, pasi shqyrtoi raportin e

paraqitur nga Grupi i Punës së KQZ, të ngritur me Urdhrin nr. 82, datë 12.10.2020, dokumentacionin e paraqitur nga administrata e KQZ-së, si dhe për të garantuar identifikimin e sigurt të zgjedhësve dhe garantimin e një procesi votimi të standardeve më të larta, me propozim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, dhe Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve,

VËREN

Neni 12, pika 4, e Kodit Zgjedhor përcakton se Komisioni Rregullator (Rregullatori) është organi kompetent për miratimin e akteve me karakter normativ në fushën e zgjedhjeve dhe vendosjen e rregullave për zgjedhjet.

Neni 20, pika 1, germa "e" të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, parashikon kompetencën e Komisionit Rregullator për miratimin e projekt-aktit me karakter normativ, të përgatitur nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, mbi llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet apo pajisjet e teknologjisë së informacionit, që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë.

Neni i 22 dhe 23, i Kodit Zgjedhor parashikojnë kompetencat e KQZ-së lidhur me teknologjinë në zgjedhje, procedurat dhe vendimmarrja.

Në nenin 179, pika 1, të Kodit Zgjedhor, parashikohet se sistemet apo pajisjet e teknologjisë së informacionit, që do të përdoren në zgjedhje, do të implementohen me projekte pilot, të cilat duhet të përfshijnë jo më shumë se 20 përqind të zgjedhësve, duke filluar nga zgjedhjet e para, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Pavarësisht nga ky rregull, në zgjedhjet e para për Kuvendin, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, identifikimi elektronik do të shtrihet në 100 përqind të votuesve.

Për përmbushjen e detyrimeve ligjore që rrjedhin nga dispozitat sipërcituar, administrata e KOZ, ka përgatitur projekt-aktin mbi llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet apo pajisjet e teknologjisë së informacionit, që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë.

PER KËTO ARSYE

Komisioni Rregullator, bazuar në nenin 12, nenin 20, pika 1, germa "e", nenin 22, 23, nenin 179, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

VENDOSI:

(shtuar fjali në shkronjën "c", të pikës 5 me Vendimin nr. 5 datë 10.2.2023)

1. Në zgjedhjet për Kuvendin, të datës 25 Prill 2021, procesi i identifikimit të zgjedhësve në të gjithë qendrat e votimit (QV) në territorin e vendit do të kryhet me ndihmën e pajisjeve elektronike, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.
2. Për identifikimin e zgjedhësve do të implementohet Sistemi Elektronik i Identifikimit të Votuesve (SEIV) dhe do të përdoren Pajisje Elektronike të Identifikimit (PEI), të vendosura në çdo qendër votimi, të cilat do të sigurojnë identifikimin e saktë të zgjedhësve, bazuar në regjistrin elektronik të mbajtur në pajisje.
3. SEIV duhet të ofrojë të gjitha modulet e nevojshme "software" si dhe pajisjet "hardware" që do të mundësojnë menaxhimin e listës së zgjedhësve dhe të dhënat e votuesve, menaxhimin e pajisjeve elektronike të identifikimit si dhe të kryqëzimit të të dhënave të identifikimit të të gjitha PEI, mbas përfundimit të votimit, për të gjurmuar votimin e të njëjtit zgjedhës më shumë se një herë në të njëjtën qendër votimi, në më shumë se një qendër votimit dhe/ose në emër të zgjedhësve të tjerë.
4. Procesi i identifikimit elektronik duhet të përfshijë të njëjtat parime identifikimi sikurse kryhet në kushte manuale, dhe nuk duhet të ndryshojë thellësisht apo të zgjasë a vështirësojë procesin e identifikimit të zgjedhësve.
5. Implementimi i SEIV duhet të sigurojë që:
 - a. Të dhënat e identifikimit të zgjedhësve të ruhen dhe përpunohen, sipas standardeve më të larta të sigurisë në memorien e PEI, dhe të zbatojnë kërkesat e legjisllacionit në fuqi për ruajtjen dhe integritetin e të dhënave personale dhe biometrike si dhe atyre të pjesëmarrjes në votim.
 - b. PEI duhet të jetë një pajisje plotësisht e integruar pa komponentë të jashtëm, e cila mund të transportohet dhe të vendoset në punë lehtësisht.
 - c. Pajisja e çdo qendre votimi duhet të veprojë në mënyrë autonome dhe pa u lidhur në rrjetet e komunikimeve elektronike.

Përfundimisht, për qëllim të pasqyimit të pjesëmarrjes në zgjedhje, çdo pajisje elektronike e identifikimit të mundësojë transmetimin periodik të të dhënave statistikore mbi pjesëmarrjen gjatë ditës së zgjedhjeve dhe statusin e qendrës së votimit, drejt serverit në cloud të KQZ, dhe jo anasjelltas, në mënyrë të sigurt dhe pa cenuar integritetin e informacionit. Rregullat e hollësishme për llojin e të dhënave që transmetohen nga pajisja PEI dhe mënyrën e transmetimit miratohen me akt të posaçëm të Komisionit Rregullator.

d. Pajisja duhet të ketë bateri për të operuar përgjatë tërë procesit të votimit, e pavarur nga energjia elektrike.

e. PEI duhet të sigurojë integritetin e të dhënave të regjistruara në të, dhe të parandalojë aksesin në këto të dhëna, të personave të paautorizuar apo nga dëmtime të karakterit fizik, a të çdo forme tjetër të parashikueshme. Aksesin ndaj çdo komponenti të brendshëm dhe/ose porte komunikimi duhet të jetë fizikisht i mbyllur dhe i siguruar me vula sigurie.

f. Çdo PEI do të përmbajë listën e zgjedhësve të të gjitha QV-ve, me të dhënat e identifikimit të çdo zgjedhësi, sipas nenit 45 të Kodit Zgjedhor, si dhe foton e çdo zgjedhësi të depozituar gjatë pajisjes me dokumente identiteti biometrik.

g. Të gjitha PEI duhet të garantojnë unitetin e të dhënave dhe do të konfigurohen si pajisje të personalizuar të qendrave të votimit respektive, me anë të kodeve përkatëse vetëm në momentin e hapjes së procesit të votimit. Çdo PEI do të shfaqë vetëm listën dhe foton e zgjedhësve të asaj qendre votimi ku është konfiguruar.

h. Të dhënat e identifikimit të kryer të çdo zgjedhësi do të përbëjnë regjistrin e votuesve (zgjedhësve që kanë votuar) do të përfshijnë çdo të dhënë, sipas pikës “f” dhe do të ruhet në një hapësirë memorie të sigurt, të veçantë dhe të ndara nga të dhënat e tjera. Në momentin e identifikimit elektronik sipas ligjit, skedari i zgjedhësit të identifikuar pas nënshkrimit me gjurmën daktiloskopike të gishtit, ruhet në memorien e votuesve.

i. PEI duhet të sigurojë shfaqjen e qartë të fotos së zgjedhësit si dhe të dhënat e tjera të identifikimit.

j. PEI i mundëson operatorit leximin e dokumentit të identitetit duke përdorur lexuesin "MRZ" (Zonën Lexuese të Makinës) për të kërkuar votuesin në bazën e të dhënave të pajisjes, ku ruhen skedarët e zgjedhësve që nuk kanë votuar.

k. PEI mundëson gjithashtu kërkimin e zgjedhësit manualisht në bazën e të dhënave, duke shkruar në pajisje numrin personal të identifikimit të zgjedhësit, emër, mbiemër dhe datëlindje. Në këtë rast, PEI duhet të regjistrojë rastin e identifikimit manual.

l. PEI do të verifikojë nëse zgjedhësit i lejohe të votojë në atë QV, dhe të shfaqë në pajisje të gjithë të dhënat e identifikimit si dhe foton e zgjedhësit.

m. PEI do të evidentojë rastet kur zgjedhësi nuk mund të votojë në atë QV dhe kur tashmë ka votuar, duke sinjalizuar.

n. Për çdo zgjedhës të identifikuar, do të nënshkruhet me gjurmën daktiloskopike të gishtit dhe PEI do të ruajë në një memorie të sigurt gjurmën e gishtit të zgjedhësit si një prove e pjesëmarrjes në votim.

o. PEI duhet të prodhojë një dokument fizik, i cili vërteton kryerjen e procesit të identifikimit. Ky dokument përmban të dhënat e zgjedhësit, si dhe foton e tij.

p. PEI duhet të identifikojë dhe regjistrojë çdo tentativë për votim të dyfishte dhe/ose në vend të zgjedhësve të tjerë.

q. PEI duhet të mundësojë procedurë të veçantë për të regjistruar identifikimin e komisionerëve që nuk e kanë emrin në atë QV, si edhe të mundësojë votimin e zgjedhësve (anëtarëve dhe sekretarit të QV), sipas parashikimeve të nenit 106, pika 4, të Kodit Zgjedhor.

r. Në momentin e fillimit të procesit, PEI do të prodhojë një procesverbal të hapjes, i cili do të firmoset nga komisioni dhe ku do të përfshihen të dhënat teknike të pajisjes si dhe numri i zgjedhësve në listë.

s. Pas mbylljes së procesit të votimit, PEI do të prodhojë një dokument fizik, i cili përmban të dhënat dhe administrohet në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe aktet normative të Komisionit Rregullator. Gjithashtu, PEI do të printojë listën e zgjedhësve që kanë votuar dhe numri i zgjedhësve që nuk kanë votuar. Të dy këto procesverbale do të jenë pjesë e materialeve zgjedhore.

t. SEIV duhet të operojë në pajisje dhe në rrjet të dedikuar (të mbyllur) në ambientet e KQZ-së.

Ky sistem duhet të ketë këto karakteristika:

- i. të jetë i paaksesueshëm nga jashtë;
- ii. pas procesit të votimit të mundësojë qendërzimin (hedhjen) e të dhënave në mënyrë të sigurt nga PEI;
- iii. të mundësojë kryqëzimin (kontrollin) e të dhënave biometrike, përfshirë gjurmët e gishtave për të identifikuar votimin e të njëjtit zgjedhës me shumë se një herë në të njëjtën qendër votimi, në më shumë se një qendër votimi dhe/ose në emër të zgjedhësve të tjerë.

6. Ofertuesi i implementimit të sistemit dhe furnizimit të pajisjeve duhet të jetë një kompani me përvojë të suksesshme ndërkombëtare, të gëzojë emër të mirë të njohur botërisht si dhe duhet të ketë realizuar

me sukses implementimin e proceseve të identifikimit dhe/ose votimit elektronik në vende me numër zgjedhësish, jo më të ulët se Republika e Shqipërisë. Ofertuesi i implementimit të sistemit nuk duhet të jetë i varur nga asnjë qeveri e asnjë shteti tjetër, as në pronësi dhe as në strukturë.

7. Ofertuesi i implementimit të sistemit dhe furnizimit të pajisjeve duhet të garantojë implementimin në 100% të qendrave të votimit në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ofertuesi i implementimit të sistemit dhe furnizimit të pajisjeve duhet të garantojë mirëmbajtjen e sistemit dhe furnizimit të pajisjeve (përfshirë zëvendësimin e PEI brenda 2 orësh) në 100% qendrave të votimit në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ofertuesi i implementimit të sistemit dhe furnizimit të pajisjeve duhet të garantojë trajnimin e trajnuesve të KQZ-së, të ngarkuar për të kryer trajnimin e Komisionerëve të QV, si dhe personave përgjegjës për përdorimin e pajisjeve të identifikimit.

8. Me qëllim implementimin dhe përdorimin e sistemit elektronik të identifikimit të votuesve në zgjedhjet për Kuvendin, të datës 25 prill 2021, duke marrë në konsideratë kohën e shkurtër në dispozicion të KQZ, si dhe referuar parashikimit ligjor të nenit 179, pika 1, të Kodit Zgjedhor, Autoriteti Kontraktor mund të përdorë procedurën e prokurimit të parashikuar në nenin 33, pika 2, germa "c" të Ligjit "Për Prokurimin Publik".

9. Për zbatimin e këtij, vendimi ngarkohet Komisioneri dhe Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, të cilët i paraqesin kërkesën Këshillit të Ministrave për alokimin e fondeve, në zbatim të nenit 179, pikës 2, të Kodit Zgjedhor.

10. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

11. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Iirjana NANO-	Kryetar
Arens ÇELA-	Anëtar
Dritan ÇAKA-	Anëtar
Helga VUKAJ-	Anëtar
Muharrem ÇAKAJ-	Anëtar